REPUBLIKA E KOSOVËS
KUVENDI I KOMUNËS-SHTIME
Nr.01-060/01-6158/26 datë:24.03.2026

Npi – 01/63 datë: 02.04.2026

Duke u bazuar në nenin 12 pika (d) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës" Nr. 28/2008); Nenit 13.1 pika (a) dhe neni 13.3 të Rregullores Komunale për ndarjen e Bursave për Studentë, Npi – 01/209 datë: 31.05.2023, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur më: 02.04.2026, miratoi:

V E N D I M

PËR ZGJEDHJEN E KOMISIONIT PËR NDARJEN E BURSAVE PËR STUDENTË PËR VITIN AKADEMIK 2025/2026

I

Kuvendi i Komunës së Shtimes, në mbledhjen e dytë të rregullt për vitin 2026, të mbajtur më: 02.04.2026, unanimisht e miratoi, Vendimin për zgjedhjen e Komisionit për ndarjen e Bursave për Student për vitin akademik 2025/2026, në përbërjen si vijon:

II

Dy anëtarë të Komisionit nga Kuvendi sipas nenit 13.1 pika (a) e Rregullores Komunale për ndarjen e Bursave për Student, Npi – 01/209 datë: 31.05.2023

1. z.Haqif Arifi.....(Përfaqësues nga pozita)
2. z.Faruk Beqa.....(Përfaqësues nga opozita)

III

Dy anëtarë të Komisionit nga Ekzekutivi, sipas nenit 13.1 pika (b) e Rregullores Komunale për ndarjen e bursave për Student, Npi – 01/209 datë: 31.05.2023, i ka emëruar Kryetari i Komunës, me vendimin Nr.02/318 të datës 03.04.2026 si vijon:

3. z.Besnik Shala.....(Zyrtar për Arsim)
4. znj.Tringa Rushiti.....(Zyrtare për Arsim)

IV

Një anëtar ftohet nga përfaqësuesit e Studentëve, sipas nenit 13.1 pika (c) e Rregullores Komunale për ndarjen e bursave për Student, Npi – 01/209 datë: 31.05.2023.

5. z.Shpresim Mahmuti.....(Përfaqësues/e e Studentëve)

V

Vendimi u dërgohet: Arkivit, Anëtarëve të Komisionit, Drejtorisë për Arsim, Kryesuesit të Kuvendit, Kryetarit të Komunës, Ministrisë të Administrimit të Pushtetit Lokal dhe Zyrës për Informim.

REPUBLIKA E KOSOVES · REPUBLIKA KOSOVA · KOMUNA E SHTIMES · OPSTINA SHTIMLJE · SHTIME-ŠTIMLJE

Kryesuesi i Kuvendit
Rrahman Jakupi